



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS
Mbledhje Rradhës
Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E ENJTE, DATA 24.12.2020, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RRADHËS NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN DHJETOR 2020
2. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN PËR NJË SHITESË NË KONTRATËN E QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, QË MBAN NR. 12644 PROT., DATË 30.07.2019, E LIDHUR NDËRMJET BASHKISË DURRËS, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “UNIEURO” SH.P.K., SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË NJË PJESË E KATIT TË PARË TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME

	930 M ² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 900 M ² DHE SIP. FUNKSIONALE 30 M ²), DHE MIRATIMIN PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE NËPËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR DHËNIEN E MIRATIMIT NGA KËSHILLI I MINISTRAVE PËR NJË SHITESË NË KONTRATËN E QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 152 M ² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 130 M ² DHE SIP. FUNKSIONALE 22 M ²), MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 507, DATË 17.7.2019
3. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË NDËRTESËN ME NR. PASURIE 5/109, ZK 8516, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 585.2 M ² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 555 M ² DHE SIP. FUNKSIONALE 30.2 M ²), NË INVENTAR TË NDËRMARRJES TREGTISË ME SHUMICË (BGT), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJET, NËPËRMJET PROÇEDURËS SË KONKURRIMIT
4. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit të këshillit	PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS PËR PERIU DHËN JANAR 2021 – DHJETOR 2021
5. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 1 (NJË) OBJEKTI BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS TË THELLUAR, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË
6. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHËMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR E PALLATEVE, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
7. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2021, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATME SËM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2021-2023
8. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATME SËM (PBA) PËR VITET 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR

9. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NGRITJES SË KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ
10. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME PROFESIONALE, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021
11. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021
Pyetje nga Këshilltarët	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet do të jenë:

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, të nenit 33, neni 34 pika 1, neni 77 pika 8, të Rregullores së Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

DATA 23.12.2020 Pika 1, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **11.00**

DATA 23.12.2020 Pikat 2,3 do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për secilin projektvendim brenda orës **12.00**

DATA 23.12.2020 Pika 4, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **13.00**

DATA 23.12.2020 Pika 5, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

- Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **14.00**

DATA 23.12.2020 Pika 6, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **14.00**

DATA 23.12.2020 Pikat 7,8,11 do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për secilin projektvendim brenda orës **19.00**

DATA 23.12.2020 Pikat 9,10, do të shqyrtohen nga:

- Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit dhe dërgojnë me e-mail Raportin e tyre për secilin projektvendim brenda orës **15.00**

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja